



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM KORÇË

Nr. Prot.

Korçë, më 10. 10. 2023

NJOFTIM

PËR SHPALLJE KONKURIMI PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË
DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR
NË KATEGORINË DREJTUESE KRYESEKRETAR

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56/7, 57, 58, 60, 62 të Ligjit nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të KLGJ-së Nr.622 datë 10.12.2020 “Për Lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhezimit nr. 85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nepërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, shpall procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë drejtuese, për pozicionin:

1 (një) pozicion – KRYESEKRETAR, kategoria e pages III-2.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nepërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë drejtuese.

Për procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE: **25.10.2023**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

NGRITJE NË DETYRË: **01.11.2023**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR: **08.11.2023**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin Kryesekretar gjyqësor është:
Kryesekretari ushtron në veçanti këto kompetenca:

- a) nënshkruan të gjitha aktet procedurale që kërkojnë njoftime procedurale, siç janë: vendimet gjyqësore që bëhen përfundimtare; vendime përfundimtare dhe të ndërmjetme që dërgohen për ekzekutim; ekstrakte dhe fotokopje të njësuara me origjinalin të akteve të gjykatës; aktet e nxjerra ose të kërkuara nga gjykata, krahas nënshkrimit të personit që i ka përgatitur;
- b) lëshon vërtetime për të dhënat e kërkuara nga palët nga regjistrat në gjykatë;
- c) merr në dorëzim dosjen pas gjykimit dhe kontrollon plotësimin e inventarit, numërtimin e fletëve, pasqyrimin nga sekretarja e seancës të shpenzimeve gjyqësore të kryera gjatë gjykimit;
- ç) dërgon menjëherë vendimet penale të gjykatës që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë edhe kur marrin formë të prerë në Ministrinë e Drejtësisë;
- d) bën njoftimet në institucionet përkatëse në zbatim të dispozitivit të vendimit gjyqësor;
- dh) përgatit buletinet për personat e dënuar me vendim të formës së prerë dhe i dërgon në Zyrën e Gjendjes Gjyqësore;
- e) bën shpërndarjen e shkresave duke ja përcjellë menjëherë kryetarit, kancelarit të gjykatës apo çdo personi tjetër përgjegjës;
- ë) krijon kodekset me kopjen më të rregullt të vendimeve me shënimet përfundimtare "Vendimi mori formë të prerë pasi (nuk u ankimua../ u ankimua/ u vendos me vendimin nr. datë të gjykatës..);
- f) bën shënimet për marrjen e vendimeve formë të prerë. Pas marrjes së vendimeve formë të prerë, dorëzon dosjet gjyqësore në arkivë dhe kontrollon rregullsinë dhe etikën e dosjes dhe bën shënimet përkatëse në regjistër;
- g) ndjek punën dhe veprimtarinë e kryesekretarisë dhe informon periodikisht kancelarin dhe kryetarin;
- gj) ndihmon në evidentimin dhe plotësimin e të dhënave dhe statistikave gjyqësore; harton nomenklaturën vjetore të çështjeve të gjykatës;
- h) është përgjegjës për mbajtjen e regjistrave manuale dhe elektronike të gjykatës.
- i) ndjek dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve të kryetarit dhe kancelarit të gjykatës që kanë të bëjnë me veprimtarinë gjyqësore ose administrative të gjykatës, si dhe realizon çdo detyrë sipas parashikimit të rregullores së brendshme të gjykatës;
- j) siguron organizimin dhe shpërndarjen në kohë të informacionit të saktë dhe të përditësuar në sallat e gjyqit në një vend të aksesueshëm për përdoruesit e gjykatës;
- k) siguron kalimin në kohë të çështjeve në arkivin e gjykatës.
- l) ndjek çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga kancelari/kryetari.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil gjyqësor, i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon; (dokument nga institucioni)
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi; (dokument nga institucioni)
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Arsimi: Diplome universitare ne drejtesi ne nivelin Master Profesional ose te barazvlefshem me te, sipas percaktimeve te legjislacionit per arsimin e larte,
- b. Përvoja: Të ketë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet përvojë pune si sekretar gjyqësor.
- c. Aftësitë të tjera: Aftësi komunikuese dhe organizative; Mos të ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierrës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta : email/adresë postare/numër telefoni;
- Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë dhe listës së notave e noterizuar (për diplomat jashtë vendit , të percillet njehsimi nga MAS),
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë),
- Fotokopje e letërnjoftimit (ID)
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (formulari i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
- Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria (qe nuk ka proces dhe procedim penal).
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet,.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pranë Zyrës së Protokollit ose nepermjet shërbimit postar, brenda datës **25.10.2023 ora 16:00**.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Kancelari i Gjykatës verifikon kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele dhe kërkesat e veçanta, të cilat përcaktohen në shpalljen e konkurrimit, dhe përgatit listën e kandidatëve të kualifikuar, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim.

Në datën **27.10.2023**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të çdo Gjykate, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet

vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Kodi i Procedurës Civile dhe Penale
- b. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,
- c. Ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- d. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- e. Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil ”, i ndryshuar,

I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej tyre dhe intervistës, nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Këshilli, brenda 2 (dy) diteve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimin të kandidatëve është 100 (njëqind), si me poshtë:

- a) **40** (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimin në punë. Në raste rezultatesh të njehta, keshilli krijon nje renditje brenda grupit të kandidateve me vlerësimin me te larte te punes;
- b) **50** (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) **10** (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

Kandidati që merr më pak se 70 (shtatëdhjetë) pikë nuk konsiderohet i suksesshëm. Këshilli i Gjykatës zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikë, për t’u emëruar në vendin e lirë.

I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimin të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

II. KONKURIMI, NEPERMJET PROCËDURËS SË NGRITJES NË DETYRË

(Në rast se pozicioni i lirë i shpallur, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, nuk është plotësuar, pra rezulton i lirë, atëherë ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë).

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civil gjyqësor të një kategorie paraardhëse, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushte për ngritjen në detyrë si vijon:

- Të jenë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, të një kategorie paraardhëse (dokument nga institucioni).
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (dokument nga institucioni).
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.
- Të plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kritet e veçanta si vijon:

- a) Arsimi: Diplomë universitare në drejtësi në nivelin Master Profesional ose të barasvlefshme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit për arsimin e lartë,
- b) Përvoja: Të ketë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre përvojë pune si sekretar gjyqësor.
- c) Aftësi të tjera: Aftësi komunikuese dhe organizative.
- d) Aftësi të tjera: Aftësi komunikuese dhe organizative; Të mos ketë masë disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme.

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta : email/adresë postare/numër telefoni;
- Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë dhe listës së notave e noterizuar (për diplomat jashtë vendit , të percillet njehsimi nga MAS),
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë),
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
- Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria (qe nuk ka proces dhe procedim penal).
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Aktin e deklarimit lidhur me statusin e nëpunësit civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë, të një kategorie paraardhëse.
- Fotokopje e kartës së identitetit (ID).
- Vërtetim banimi.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ose nepermjet shërbimit postar brenda datës **01.11.2023**.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **02.11.2023** Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i Gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

II.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Kodi i Procedurës Civile dhe Penale;
- b. Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";
- c. Ligji nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", i ndryshuar;
- d. Ligji nr.152/2013 " Për nëpunësit civil", i ndryshuar;
- e. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat etike në administratën publike";

II.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

1. **70** pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë:
 - a) **30 (tridhjetë)** pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;
 - b) **30 (tridhjetë)** pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
 - c) **10 (dhjetë)** pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.
2. **30 (tridhjetë)** pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

1.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA, E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ www.klgj.al dhe të gjykatës.

III. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË DREJTUESE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë drejtuese.

III.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur,
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Arsimi: Diplomë universitare në drejtësi në nivelin 'Master Shkencor ose të barazvlefshëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionin për arsimin e lartë;
- b) Përvoja: Të ketë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet përvojë pune si sekretar gjyqësor.
- c) Aftësitë të tjera: Aftësi komunikuese dhe organizative:
Të mos ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme.

III.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta : email/adresë postare/numër telefoni;
- Fotokopje të diplomës së arsimin të lartë dhe listës së notave e noterizuar (për diplomat jashtë vendit , të percillet njehsimi nga MAS),
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë),
- Fotokopje e letërnjoftimit (ID)
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).

- Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (formulari i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
- Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria (që nuk ka proces dhe procedim penal).
- Vlerësimin e fundit nga eprori direct.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet,.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ose nepermjet shërbimit postar brenda datës **08.11.2023**.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **10.11.2023**, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë drejtuese dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Këshillin e Gjykatës, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Kodi i Procedurës Civile dhe Penale
- b. Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";
- c. Ligji nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor" i ndryshuar;
- d. Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësit civil", i ndryshuar;
- e. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat etike në administratën publike";

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. **60 (gjashtëdhjetë)** pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. **40 (dyzet)** pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë drejtuese, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë drejtuese:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor eëë.klgj.al dhe të Gjykatës.

KËSHILLI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

V.0: Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.85, date 11,03.2021 "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të www.klgj.al.

